VENDIM
Nr.646, datë 28.7.2010

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar dhe paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të posedues ve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) në qarkun Tiranë, 5445 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 784 513, 40 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje dyzet) m²;

b) në qarkun Durrës, 518 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 184 510,40 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dhjetë presje dyzet) m²;

c) në qarkun Shkodër, 7 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 439,90 (katërqind e tridhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë) m²;

ç) në qarkun Lezhë, 76 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 31 089,06 (tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e nëntë presje zero gjashtë) m²;

d) në qarkun Berat, 86 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 25 513,35 (njëzet e pesë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje tridhjetë e pesë) m²;

dh) në qarkun Fier, 495 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 138 618,38 (njëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tridhjetë e tetë) m²;

e) në qarkun Korçë, 2 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 325,69 (treqind e njëzet e pesë presje gjashtëdhjetë e nëntë) m²;

ë) në qarkun Elbasan, 370 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 85 247,50 (tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzet e shtatë presje pesëdhjetë) m²;

f) në qarkun Gjirokastër, 15 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 854,40 (dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër presje dyzet) m²;

g) në qarkun Vlorë, 416 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 156 308,50 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetë presje pesëdhjetë) m²;

gj) në qarkun Kukës, 64 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 28 733,47 (njëzet e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre presje dyzet e shtatë) m²;

h) në qarkun Dibër, 22 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 409,20 (katër mijë e katërqind e nëntë presje njëzet) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha